



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 01/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësive Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji mbi ndarjet buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2021.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 02/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Financiare për IPA 2020 ndërmjet Republikës së Kosovës dhe Bashkimit Evropian.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 03/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Projektligji për Masat për Uljen e Kosotos së Shtrirjes së Rrjeteve të Komunikimeve Elektronike të Shpejtësisë së Lartë.
2. Projektligji nga pika 1. e këtij vendimi i dërgohet Kuvendit të Republikës së Kosovës për shqyrtim dhe miratim.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 04/38
Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

Për ndryshimin dhe plotësimin e Programit Legjislativ të vitit 2020

1. Ndryshohet dhe plotësohet Programi Legjislativ për vitin 2020 i Qeverisë së Republikës së Kosovës, si në vijim:
 - 1.1 Projektligji për Shërbimin Korrektues dhe Shërbimin Sprovues (MD) ndahet në dy projektligje:
 - 1.1.1 Projektligji për Shërbimin Korrektues të Kosovës (MD), afati i miratimit 30.11.2020; dhe,
 - 1.1.2 Projektligji për Shërbimin Sprovues të Kosovës (MD), afati i miratimit 30.11.2020.
 - 1.2 Shtyhet afati i miratimit në Qeveri, i këtyre projektligjeve:
 - 1.2.1 Projektligji për Pensionet e Zyrtarëve Policor të Policisë së Kosovës dhe Punonjësit e Inspektoratit Policor të Kosovës me Autorizime Policore (MPB), afati i miratimit 31.11.2020;
 - 1.2.2 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L-015 për Letërnjoftim (MPB), afati i miratimit 16.11.2020;
 - 1.2.3 Projektligji për Tubimet Publike (MPB), afati i miratimit 23.12.2020;
 - 1.2.4 Projektligji për Sigurinë Kibernetike (MPB), afati i miratimit 30.11.2020;
 - 1.2.5 Projektligji për Rendin dhe Qetësinë Publike (MPB), afati i miratimit 23.12.2020;
 - 1.2.6 Projektligji për Amandamentimin e Ligjit Nr.04/L-061 për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore dhe Ligjin Nr. 04/L-247, për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-061, për Shitjen e Banesave për të Cilat Ekziston e Drejta Banesore (MEA), afati i miratimit 31.10.2020;
 - 1.2.7 Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-147 për Ujërat e Kosovës (MEA), afati i miratimit 31.12.2020;
 - 1.2.8 Projektligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja (MEA),afati i miratimit 30.10.2020;

- 1.2.9 Projektligji për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për Mbeturina (MEA), afati i miratimit 30.10.2020;
- 1.2.10 Projektligji për Trajtimin dhe Kategorizimin e Personave me Aftësi të Kufizuara (MPMS), afati i miratimit 30.11.2020;
- 1.2.11 Projektligji për Shërbime Sociale (MPMS), afati i miratimit 15.12.2020;
- 1.2.12 Projektligji për Zbatimin e Sanksioneve Financiare të Shënjestruara (MPJD), afati i miratimit 02.11.2020;
- 1.2.13 Projektligjin për Ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë së Malit të Zi në kontekstin e aderimit në Bashkimin Evropian (MPJD), afati i miratimit 02.11.2020;
- 1.2.14 Projektligji për Diasporën(MPJD), afati i miratimit 01.12.2020;
- 1.2.15 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 03/L-042 i produkteve për mbrojtjen e bimëve (MBPZHR), afati i miratimit 15.12.2020;
- 1.2.16 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit nr. 04/L-041 për Prodhimin, Grumbullimin, Përpunimin dhe Tregtimin e Duhanit (MBPZHR) afati i miratimit 15.12.2020;
- 1.2.17 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L - 074 për Shërbime Këshilluese për Bujqësi dhe Zhvillim Rural (MBPZHR), afati i miratimit 15.12.2020;
- 1.2.18 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L - 016 për Ushqimin (MBPZHR), afati i miratimit 15.12.2020; dhe,
- 1.2.19 Projektligji për Pijet e Forta Alkoolike (MBPZHR), afati i miratimit 15.12.2020.

1.3 Shtohen në Programin Legjislativ për vitin 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës këto projektligje:

- 1.3.1 Projektligji për Ratifikimin e Marrëveshjes Ndërmjet Qeverisë së Republikës së Kosovës dhe Qeverisë Hungareze lidhur me amendamentin nr.1 të Marrëveshjes lidhur me Programin Kornizë për Bashkëpunim Financiar (MF);
- 1.3.2 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publik (MPB);
- 1.3.3 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-111 për Pagat në Sektorin Publik (MPB);
- 1.3.4 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-36 për Duhanin;
- 1.3.5 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-78 për Shëndetësi Publike;
- 1.3.6 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L -024 për Shërbimin Mjekësor Emergjent;
- 1.3.7 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin Ligjit Nr. 04/L-192 për Transplantimin e Indeve dhe Qelizave;
- 1.3.8 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L -190 Për Produkte dhe Pajisje Medicinale;
- 1.3.9 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-156 për Kontrollin e Duhanit;
- 1.3.10 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 06/L-042 për Gjak dhe Përbërës të Gjakut;
- 1.3.11 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-110 për Ndërprerjen e Shtatzënisë;
- 1.3.12 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 05/L -023 për Mbrojtjen e të Ushqyerit me Qumësht Gjiri;
- 1.3.13 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 2003/22 për Inspektoratin Sanitar të Kosovës;
- 1.3.14 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.2004/38 për të Drejtat dhe Përgjegjësitë e Qytetarëve në Kujdesin Shëndetësor;


1.3.15 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 02/L-38 për Inspektoratin Shëndetësor.

1.4 Tërhiqet nga Programi Legjislativ për vitin 2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës:

1.4.1 Projektligji për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr.04/L-106 për Teatrot e Kosovës (MKRS).

- 2 Obligohet Sekretari i Përgjithshëm në Zyrën e Kryeministrit që vendimin t'ia dërgojë Kuvendit të Republikës së Kosovës.
- 3 Obligohet Zyra Ligjore në Zyrën e Kryeministrit për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 05/38

Datë: 30.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, Ligjit nr. 03/L-163 për Miniera dhe Minerale i ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 04/L-158, në pajtim me Ligjin Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Themelohet Komisioni ad-hoc prej tre (3) anëtarëve për shqyrtimin e ankesave për procesin e rekrutimit të katër (4) anëtarëve të Bordit në Komisionin e Pavarur për Miniera dhe Minerale /KPMM
 - 1.1. Ibër Alaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit, Kryesues;
 - 1.2. Rozafa Ukimeraj, Sekretare e Përgjithshme e Ministrisë së Pushtetit Lokal, anëtare;
 - 1.3. Besim Kamberaj, Zv. Sekretar i Përgjithshëm i Ministrisë së Zhvillimit Rajonal, anëtar.
2. Komisioni ka për obligim të shqyrtojë të gjitha ankesat në përputhje me legjislacionin në fuqi.
3. Vetëm nëse ankesa është e pranueshme, Komisioni do të shqyrtojë ligjshmërinë dhe përshtatshmërinë e aktit administrativ të ankimuar.
4. Komisioni do të vendos mbi çështjen e ankesës dhe do të njoftoj palën ankuese për vendimin e marrë brenda afatit të paraparë ligjor sipas Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.

5. Vendimi hyn në fuqi publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrave (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Anëtarëve të Komisionit
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr.06/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Punëve të Brendshme për bartjen e mjeteve në Komunitat e Kosovës në shumë prej tetëqindëgjathtë mijë e njëqindëntëdhjetë euro (806,190€).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Ministria e Punëve të Brendshme me kod 214, nën programin Agjencia për Menaxhimin Emergjent me kod 32700 nga kategoria e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa" dhe transferohen në Komunitat e Kosovës në kategorinë e shpenzimeve "Paga dhe Shtesa" sipas tabelës së bashkangjitur.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme si dhe Komunitat e Kosovës për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Transfer I mjeteve nga AME/MPB ne Komuna
 Plani financiar per realizimin e (ndrrimeve te nates, festat zyrtare, oret shites)per NJPZSH ne nivel vendi
 214/32700

Nr.	Komuna	Transfer nga AME	Kodi buxhetor	Numri I zjarrfikese	paga shites	kontributi I pundhensit	Shuma totale	Shuma e pergjithshme
1	Fushë-Kosovë	214/32700	10-18210-612-0320	5	1,100.00	55.00	1,155.00	5,775.00
2	Novobërd	214/32700	10-18190-654-0451	9	1,100.00	55.00	1,155.00	10,395.00
3	Deqan	214/32700	10-18275-631-0320	12	1,100.00	55.00	1,155.00	13,860.00
3a	Deqan	214/32700	10-18015-631-0451	1	1,100.00	55.00	1,155.00	1,155.00
3b	Deqan	214/32700	10-18315-631-0133	1	1,100.00	55.00	1,155.00	1,155.00
4	Dragash	214/32700	10-18413-621-0320	17	1,100.00	55.00	1,155.00	19,635.00
5	Drenas	214/32700	10-18001-611-0451	17	1,100.00	55.00	1,155.00	19,635.00
6	Ferizaj	214/32700	10-18436-656-0320	28	1,100.00	55.00	1,155.00	32,340.00
7	Gjakovë	214/32700	10-18420-632-0320	42	1,100.00	55.00	1,155.00	48,510.00
8	Gjilan	214/32700	10-18431-651-0320	33	1,100.00	55.00	1,155.00	38,115.00
9	Hani i Elezit	214/32700	10-18444-659-0320	6	1,100.00	55.00	1,155.00	6,930.00
10	Istog	214/32700	10-18017-633-0451	12	1,100.00	55.00	1,155.00	13,860.00
11	Junik	214/32700	10-18020-636-0451	4	1,100.00	55.00	1,155.00	4,620.00
12	Kamenice	214/32700	10-18433-653-0320	32	1,100.00	55.00	1,155.00	35,560.00
13	Klaqnik	214/32700	10-652-18432-0320	18	1,100.00	55.00	1,155.00	20,790.00
14	Kline	214/32700	10-18422-634-0320	16	1,100.00	55.00	1,155.00	18,480.00
15	Leposaviq	214/32700	10-18425-641-0320	15	1,100.00	55.00	1,155.00	17,325.00
15a	Leposaviq	214/32700	10-18021-641-0451	2	1,100.00	55.00	1,155.00	2,310.00
15b	Leposaviq	214/32700	10-85021-641-0320	1	1,100.00	55.00	1,155.00	1,155.00
15c	Leposaviq	214/32700	10-16321-641-0133	1	1,100.00	55.00	1,155.00	1,155.00
16	Lipjan	214/32700	10-18215-613-0320	20	1,100.00	55.00	1,155.00	23,100.00
17	Malishev	214/32700	10-18417-625-0320	18	1,100.00	55.00	1,155.00	20,790.00
18	Mamushë	214/32700	10-18418-626-0320	7	1,100.00	55.00	1,155.00	8,085.00
19	Mitrovica	214/32700	10-18310-642-0320	38	1,100.00	55.00	1,155.00	43,890.00
20	Mitrovica veriore	214/32700	10-18442-647-0320	30	1,100.00	55.00	1,155.00	34,650.00
21	Pejë	214/32700	10-18295-635-0320	38	1,100.00	55.00	1,155.00	43,890.00
22	Podujevë	214/32700	10-18225-615-0320	17	1,100.00	55.00	1,155.00	19,635.00
23	Prishtinë	214/32700	10-18230-616-0320	94	1,100.00	55.00	1,155.00	108,570.00
24	Prizren	214/32700	10-18414-622-0320	25	1,100.00	55.00	1,155.00	28,875.00
25	Rahovec	214/32700	10-18415-623-0320	18	1,100.00	55.00	1,155.00	20,790.00
26	Shterpecë	214/32700	10-18355-655-0320	5	1,100.00	55.00	1,155.00	5,775.00
27	Shtime	214/32700	10-18411-617-0320	8	1,100.00	55.00	1,155.00	9,240.00
28	Skenderaj	214/32700	10-18023-643-0451	19	1,100.00	55.00	1,155.00	21,945.00
29	Suharekë	214/32700	10-18012-624-045	16	1,100.00	55.00	1,155.00	18,430.00
30	Viti	214/32700	10-18365-657-0320	27	1,100.00	55.00	1,155.00	31,185.00
31	Vushtrri	214/32700	10-18428-644-320	31	1,100.00	55.00	1,155.00	35,805.00
32	Zubin potok	214/32700	10-18429-645-0320	12	1,100.00	55.00	1,155.00	13,860.00
33	Zveqan	214/32700	10-18430-646-0320	3	1,100.00	55.00	1,155.00	3,465.00



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 07/38


Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 15 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 07/L-001 mbi Ndarjet Buxhetore për Buxhetin e Republikës së Kosovës për vitin 2020, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve për transferin e mjeteve nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" në kategorinë e shpenzimeve "Mallrat dhe shërbimet" në shumën prej njëqindtridhjetetë mijë e nëntëqindedyzet euro (138,940€).
2. Mjetet financiare nga pika 1. e këtij vendimi merren nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve me kod 320, nën programin Zgjedhjet me kod 14200, nga kategoria e shpenzimeve "Shpenzime kapitale" fondi burimor 10 nga projekti "Zhvillimi i softuerit të qendrës së numërimit dhe rezultateve" me kod 18716 dhe transferohen në programin Zgjedhjet me kod 14200 në kategorinë e shpenzimeve "Mallra dhe shërbime", për mbajtjen e zgjedhjeve të jashtëzakonshme për kryetar komune në Mitrovicë të Veriut.
3. Obligohet Ministria e Financave dhe Komisioni Qendror i Zgjedhjeve për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 08/38
Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndalohen të gjitha shtesat për zyrtarët në organizatat buxhetore, që janë në kundërshtim me nenin 80 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, Ligjin Nr. 04/L-116, Ligjin Nr. 04/L-194, Ligjin Nr. 05/L-063, Ligjin Nr. 05/L-007 dhe me Ligjin Nr. 06/L-021.
2. Obligohen të gjithë Udhëheqësit dhe/apo Zyrtarët Kryesor Administrativ të organizatave buxhetore të identifikojnë vendimet e veçanta për këto shtesa dhe t'i shfuqizojnë ato deri më 30 tetor 2020, dhe të mos i përfshijnë në listën e pagave të muajit nëntor.
3. Shtesat që nuk janë në kundërshtim me nenin 80 të LMFP-së, si dhe kanë bazë në legjislacionin në fuqi për shërbimin civil mbeten në fuqi dhe nuk ndikohen nga ky vendim.
4. Obligohen Ministria e Financave dhe Ministria e Punëve të Brendshme që t'i ofrojnë organizatave buxhetore sqarimet përkatëse për ligjshmërinë e shtesave, sipas kërkesave të këtij vendimi.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 09/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 45 paragrafit 1. të Ligjit Nr.03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 03/L-221, me Ligjin Nr. 04/L-116, me Ligjin Nr. 04/L-194, me Ligjin Nr. 05/L-063 dhe me Ligjin Nr. 05/L-007, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Raporti Nëntëmuor i Buxhetit të Republikës së Kosovës për vitin 2020.
2. Obligohet Sekretari i Përgjithshëm i Zyrës së Kryeministrit që Raportin nga pika 1. e këtij vendimi ta dorëzoj në Kuvendin e Republikës së Kosovës konform kërkesave të nenit 45 të Ligjit Nr. 03/L-048 për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, me plotësimet dhe ndryshimet e bëra.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 10/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Për përmbushjen e kontributit vjetor të Qeverisë së Republikës së Kosovës në Qendrën Rajonale të Nismës Rajonale për Migrim, Azil dhe Refugjat (MARRI), me seli në Shkup, ndahen mjete financiare për vitin 2020 në vlerë prej 20,721.00 euro (njëzetë mijë e shtatëqindnjëzet e një) euro.
2. Shuma në vlerën e sipërpërmendur ndahet nga kategoria e Mallrave dhe Shërbimeve, nga programi Shërbimet e Administratës Qendrore – MPB me kodin 11314, dhe barten në xhirollogarinë IBAN: MK 07300702000289866 EUR, S.W.I.F.T.:KOBSMK2X, Komercijalna Banka A.D. Skopje.
3. Obligohet Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 11/38


Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjesisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet ndryshimi dhe plotësimi i Planit Strategjik 2019-2021 për Rezervat Shtetërore të Mallrave, me Planin e Ri Strategjik dhe Programin vjetor 2021-2023.
2. Obligohet Ministria e Tregtisë dhe Industrisë për zbatimin e Planit dhe programit nga pika 1. e këtij vendimi në pajtim me Kornizën Afatmesme të Shpenzimeve dhe Ligjin vjetor të Buxhetit.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 12/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, bazuar në Vendimin Nr. 10/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet Plani i Veprimit i Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me të cilin janë përcaktuar kriteret për shpërndarjen e mjeteve buxhetore në vlerë prej 2.5 milion euro të ndara për MKRS-në me Vendimin Nr. 10/33 të datës 28.09.2020 të Qeverisë së Republikës së Kosovës.
2. Obligohet Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe Ministria e Financave për zbatimin e këtij vendimi.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 13/38
Datë: 30.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, bazuar në nenin 167 paragrafi 5 të Ligjit Nr. 04/L-065 për të Drejtën e Autorit dhe të Drejtat e Përafërta, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, si dhe duke u bazuar në Vendimin e Qeverisë Nr. 08/109 të datës 02.07.2019, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet/plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr.12/36 i datës 19.10.2020.
2. Pika një (1) e Vendimit Nr.12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet/plotësohet si vijon:
 - 2.1. Aprovohen Tarifatat e Përgjithshme Mujore për Shfrytëzimin e Lëndës së Mbrojtur me rastin e Ritransmetimit.
3. Pika dy (2), e Vendimit Nr. 12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet/plotësohet si vijon:
 - 3.1. Tarifa mujore për kompensim bazohet për grupet e kanaleve televizive të ritransmetuara sipas kategorizimit, si në vijim:
 - 3.1.1. Deri në 70 TV kanale – 0.30 euro për abonues;
 - 3.1.2. Nga 71 deri në 100 TV kanale – 0.35 euro për abonues;
 - 3.1.3. Nga 101 deri në 150 TV kanale – 0.40 euro për abonues;
 - 3.1.4. Mbi 151 TV kanale – 0.45 euro për abonues.
4. Pika tre (3) e Vendimit Nr.12/36, të datës 19.10.2020, ndryshohet plotësohet si në vijim:
 - 4.1. Obligohen të gjithë operatorët kabllorë dhe subjektet tjera që të bëjnë ritransmetimin e kanaleve televizive për zbatimin e këtij Vendimi.
 - 4.2. Zbatimi i Vendimit, përkatësisht tarifave të Përgjithshme Mujore për Shfrytëzimin e Lëndës së Mbrojtur me rastin e Ritransmetimit, fillon nga data 01.04.2021.
5. Dispozitat tjera të Vendimit Nr. 12/36 i datës 19.10.2020, mbeten të pandryshuara.

6. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Komisionit të Pavarur të Mediave
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 14/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Aprovohet kërkesa e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sportit me Nr. 2970 e datës 22.10.2020, për shpalljen e muajit Nëntor 2020 "Muaji i Anton Çetës".
2. Miratohet Programi dhe aktivitetet e propozuara nga Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit në kërkesën me Nr. 2970 të datës 22.10.2020, për shpalljen e muajit Nëntor 2020 "Muaji i Anton Çetës", i cili program, është shtojcë e këtij Vendimi.
3. Për zbatimin e këtij Vendimi, obligohen Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit dhe të gjitha institucionet tjera të përfshira në programin me aktivitetet të cilat janë nën autoritetin e pushtetit ekzekutiv në Republikën e Kosovës, në bashkëpunim me institucione tjera.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë

Muaji i Anton Çetës

Viti 2020 shënon **100 vjetorin e lindjes dhe 25 vjetorin e vdekjes** së prof. Anton Çetës, intelektualit të ndritur, mbledhësit të shquar të folklorit, shkrimtarit të njohur e pajtuesit të palodhur të gjaqeve.

Njëkohësisht, viti 2020 shënon **30 vjetorin e pajtimit të gjaqeve**, kthesës historike mbarë popullore në Kosovë e jashtë saj, që i kontribuoi zhdukjes së hasmërive dhe shërimit të shoqërisë shqiptare e pajtimit mes njerëzve.

Profesor Anton Çeta lindi në Gjakovë më 3 janar 1920. Mësimet e para i mori në vendlindje, të mesmet në Tiranë, në Korçë e në Milano të Italisë. Deri në vitin 1950 studioi romanistikë në Universitetin e Beogradit ku, posa u diplomua, nisi punën e asistentit në katedrën e albanologjisë. Me hapjen e fakultetit filozofik të Prishtinës, Prof. Anton Çeta u emërua ligjërues për letërsinë e vjetër shqipe. Nga viti 1968 e deri sa doli në pension, vijoi të punonte së bashkëpunëtor shkencor në Institutin Albanologjik të Prishtinës, duke kryesuar degën e folklorit dhe botimin e revistës “Gjurmime albanologjike” – folklor e etnologji. Që nga viti 1990 prof. Anton Çeta u vu në krye të aksionit mbarë popullor për pajtimin e gjaqeve. Dha kontribut të veçantë në përfundimin e rrugës për liri e pavarësi të Kosovës, deri më 2 nëntor 1995, kur edhe ndërroi jetë.

Tubimi në Verrat e Llukës do të mbetet si momenti bashkimit më të madh të shqiptarëve të Kosovës. Më 2 shkurt 1990 me nismën e Anton Çetës nisi në Kosovë aksioni atdhetar e humanitar i faljes së gjaqeve që mori përmasa të gjera, duke u përhapur anembanë vendit. Ky konsiderohet edhe si viti më i organizuar dhe më frytdhënës i kombit shqiptar që hyri në histori si vit i bashkimit e i pajtimit të popullit tonë kudo që jetonte, brenda trojeve etnike dhe mërgatë.

Profesor Anton Çeta pa dyshim është institucion i urtisë së popullit shqiptar, zbulues i thesarit të tij e i shpirtit të tij.

Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit propozon që muaji nëntor të quhet **Muaji i Anton Çetës** dhe të shënohet si i tillë me një varg aktivitetesh si vijon:

1. Përrurimi i veprave të Anton Çetës

Institucionet e përfshira: Ministria e Arsimit, Instituti Albanologjik, MKRS dhe Biblioteka Kombëtare “Pjeter Bogdani”

Krijime Poetike për fëmijë
Ne prehër të gjyshes- Vjeti Gazmuer

Nga Folklori ynë I-Përralla e Gojëdhëna

Nga Folklori ynë II-Kallëzime dhe Përrallëza

Nga Folklori ynë III-Pleqni dhe Tregime etnografike

Nga Folklori ynë IV

Nga Folklori ynë V

Kërkime Folklorike

Balada dhe legjenda

Këngë Kreshnike I

Varia

Te tjerët për Veprën e Anton Çetës

Anton Ceta dhe Aksioni i pajtimit te gjaqeve

Intervista dhe letërkëmbime

2. ***Përrurimi i Kullës se Fazli Buqollit ne Raushiq***
Investim i Ministrise se Kulturës, Rinisë dhe Sportit
3. ***Këndi i Anton Çetës – Ekspozite ne Muzeun Kombëtar të Kosovës***
Institucionet e përfshira: MKRS dhe Muzeu Kombëtar i Kosovës
Ekspozita me titull “ Oda e oxhakut “
4. ***Emisione Televizive- RTK***
Institucionet e përfshira : RTK dhe MKRS
Shfaqja e emisioneve dhe dokumentareve te vjetra dhe punimi i një dokumentari te ri
5. ***Simpozium shkencor ne Prishtinë dhe Tiranë***
Institucionet e përfshira: MKRS, Instituti Albanologjik dhe Ministria e Kulturës dhe Biblioteka Kombëtare e Shqipërisë Jeta dhe vepra e Anton Çetës
6. ***Ekspozitë e fotografive ne Prishtinë dhe Tiranë***
MKRS, Muzeu Kombëtar i Kosovës dhe Muzeu Historik ne Tiranë
7. ***Themelimi i Çmimit “ Anton Çeta “***
Ministria e Kulturës, Rinisë dhe Sportit propozon themelimin e çmimit vjetor “ Anton Çeta “ i cili u jepet personaliteteve te shquara dhe profesionistev te dalluar te cilët me angazhimin e tyre kane pasur ndikim te drejtpërdrejtë ne avancimin e trashëgimisë kulturore- shpirtërore si dhe kane nxitur te arriturat ne mbledhjen, dokumentimin, ruajtjen dhe promovimin e folklorit.



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 15/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 5 paragrafi 1, dhe neni 43 paragrafi 1 të Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, neni 22 i Ligjit Nr. 04/L-111 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 03/L-087 për Ndërmarrjet Publike, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Ndryshohet dhe plotësohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/16, i datës 24.07.2020, për emërimin e anëtarit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" Sh.A.
2. Ndryshohet paragrafi 1.2 i vendimit bazë, ashtu që Znj. Bahrije Spanca caktohet anëtare e Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve në Ndërmarrjen Publike Qendrore "Telekomi i Kosovës" SH.A dhe shërben në cilësinë e anëtarit të Bordit të Përkohshëm të Drejtorëve, deri në përzgjedhjen e Bordit me mandat të plotë.
3. Emërimi sipas nenit 2. të këtij Vendimi, bëhet pas dorëheqjes së anëtarit të Bordit të Përkohshëm të kësaj ndërmarrje z. Kushtrim Krasniqi, në përputhje me legjislacionin në fuqi për ndërmarrjet publike.
4. Ky vendim është pjesë përbërëse e Vendimit të Qeverisë Nr. 01/16, të datës 24.07.2020.
5. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTTI


Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 16/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, në zbatim të paragrafit 1.4 dhe paragrafit 2 të paragrafit 1.4 dhe paragrafit 2 të Vendimit të Qeverisë Nr. 10/33 me datë 28.09.2020, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Miratohen kriteret për mbështetjen e sektorit privat në fushat specifike nën programin Ndërmarrësia me kod 49400, në zbatimin e masave nga Qeveria e Republikës së Kosovës në përputhje me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.
2. Obligohet Ministria e Financave dhe Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit për zbatimin e këtij Vendimi.
3. Pjesë e këtij Vendimi janë kriteret përkatëse për zbatim të masave në përputhje me Programin e Rimëkëmbjes Ekonomike.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada - Government

Ministria e Ekonomisë dhe Ambientit
Ministarstvo Ekonomije i Zivotne Sredine/Ministry of Economy and Environment

KRITERET PËR MBËSHTETJEN E SEKTORIT PRIVAT NË FUSHAT SPECIFIKE PËR NËN PROGRAMIN NDËRMARRËSIA

Kriteret për shpalljen e thirrjes publike për mbështetje financiare publike për projekte/programme për: "Thirrje publike për financimin e Mikro Bizneseve në fushat specifike", janë përcaktuar konform Udhëzimit Administrativ (MIN) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve.

1. Dokumentacioni për zbatimin e thirrjes përfshinë:
 - 1.1. Thirrjen Publike për financimin e Mikro Bizneseve në fusha specifike.
 - 1.2. Kriteret e vlerësimit
 - 1.3. Formularët për aplikim
 - 1.4. Deklaratën nën betim mbi financimin e dyfishtë
 - 1.5. Kriteret e përgjithshme
 - 1.6. Udhëzuesi dhe kriteret për aplikantët e granteve MEA/2020
 - 1.7. Plani Operacional për Subvencionim të Mikro Ndërmarrjeve
2. Formularët e aplikimit referuar në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 2.1. Formulari i Aplikacionit për Projekt/programit (*e detyrueshme*)-
 - 2.2. Formulari i Buxhetit (*e detyrueshme*)-
 - 2.3. Formulari i deklaratës për të financimit të dyfishtë (*e detyrueshme*)-
 - 2.4. Formulari i deklaratës se projekteve të financuara (*e detyrueshme*)-
 - 2.5. Deklaratë pranimit për kryerjen e aktiviteteve në projekt (*e detyrueshme*)-
 - 2.6. Formulari për aktivitetin e ndërmarrjes (*e detyrueshme*)-
3. Formularët për zbatimin dhe raportimin e projekteve të referuara në paragrafin 1 të këtij neni janë:
 - 3.1. Forma e kontratës për financimin e programit apo projektit
 - 3.2. Formulari për përgatitjen e raportit narrativ për projektin apo programin
 - 3.3. Formulari për përgatitjen e raportit financiar të programit apo projektit

Thirrja publike dhe dokumentacioni për zbatimin e thirrjes do të publikohen në mënyrë të plotë në faqen e internetit të ofruesit të burimeve financiare.

Në përputhje me "Udhëzimin Administrativ (MIN) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve" dhe udhëzuesit për aplikantët, ofruesi i mbështetjes financiare publike do të krijojë një Komision Vlerësues për hapjen dhe regjistrimin e aplikacioneve si dhe verifikimin e kushteve të përcaktuara të thirrjes publike.

Komisioni vlerësues do të bëjë vlerësimin e përmbajtjes së aplikacioneve të projekteve të pranuar që kanë përmbushur me sukses kushtet formale për të qenë pjesë e konkurrimit sipas paragrafit 1 të këtij neni.

Anëtarët e Komisionit Vlerësues do të punojë në përputhje me procedurën e përcaktuar në Udhëzimet për aplikuesit dhe rregullat e parapara me Udhëzimin Administrativ (MIN) Nr.01/2018 për Ndarjen e Mjeteve Financiare nga Kategoria Ekonomike e Subvencioneve dhe Transfereve.

Pasi të merret vendimi mbi aplikuesit e suksesshëm, projektet e të cilëve i plotësojnë kushtet për financim, udhëheqësi i institucionit (ZKA) merr vendim për ndarjen e mjeteve për financimin e projekteve/programeve të NM-ve.

Ofruesi i mbështetjes financiare do të njoftoj përfituesit për kohën e nënshkrimit të kontratave.

Prishtinë, 21.10.2020



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 17/38

Datë: 30.10.2020

Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. dhe të nenit 93 paragrafi (4) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenin 64 dhe 66 të Ligjit 04/L-125 për Shëndetësi, nenit 11 të Statutit të Shërbimit Spitalor dhe Klinik Universitar të Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr.07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Plotësohet dhe ndryshohet Vendimi i Qeverisë Nr. 01/17 i datës 27.03.2020 me të cilin është emëruar Bordi Drejtues i Shërbimit Spitalor Klinik Universitar të Kosovës si në vijim:
 - 1.1. Dr. Diana Dafota - Spitali i Përgjithshëm Gjakovë zëvendësohet me Dr. Naim Hoxha Spitali i Përgjithshëm i Ferizajit, në bazë të rotacionit dhe përmbushjes së indikatorëve të kualitetit të shërbimeve shëndetësore, sipas propozimit të SHSKUK;
 - 1.2. Dr. Sadete Hadri, për shkak të pensionimit, zëvendësohet me Dr. Vjollca Kadolli - Shërbimet e kujdesit parësor shëndetësor, sipas rekomandimit të asociacionit të komunave;
 - 1.3. Dr. Mirsad Shkreta, për shkak të ndërrimit të kabinetit, zëvendësohet me Dr. Diellor Rizaj - Ministria e Shëndetësisë.
2. Pjesa tjetër e Vendimit mbetet e pandryshuar.
3. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HOTI

Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government

Nr. 18/38

Datë: 30.10.2020


Në mbështetje të nenit 92 paragrafi 4. të nenit 93 paragrafi (4) dhe 55 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës, të nenit 20 të Ligjit Nr. 07/L-006 për Parandalimin dhe Luftimin e Pandemisë Covid 19 në Territorin e Republikës së Kosovës, duke u bazuar në nenin 4 të Rregullores Nr. 06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive, e ndryshuar dhe e plotësuar me Rregulloren Nr. 07/2020, në pajtim me nenin 19 të Rregullores së Punës së Qeverisë së Republikës së Kosovës Nr. 09/2011, Qeveria e Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 30 tetor 2020, merr këtë:

V E N D I M

1. Për shkak të pandemisë, shtesat mujore mbi pagën bazë për personelin aktiv në vend të punës për muajin e plotë për të cilin merret shtesa në institucioneve shëndetësore publike përmes listës së pagave në të tri nivelet e kujdesit shëndetësor të angazhuar në betejën kundër pandemisë COVID-19 për muajin shtator, tetor, nëntor dhe dhjetor 2020 do të jenë si në vijim:
 - 1.1. Kategoria I -Mjekë, ju ndahet shtesa prej 250.00 € në muaj;
 - 1.2. Kategoria II -Infermierëve, ju ndahet shtesa prej 150.00 € në muaj;
 - 1.3. Kategoria III - Staf mbështetës/teknik, ju ndahet shtesa prej 100.00 € në muaj.
2. Buxheti për të paguar këto shtesa merret nga linjat aktuale buxhetore përmes alokimeve të parakohshme dhe harmonizimeve të brendshme në vetë organizatat ku jepen shtesat. Ndërsa në linjat që ka mungesa buxhetore, buxheti do të sigurohet me një vendim të veçantë të Qeverisë. Paguesa e këtyre shteave do të jetë subjekt i sigurimit të buxhetit paraprakisht.
3. Organizatat buxhetore janë përgjegjëse të përgatisin dhe të aprovojnë me shkresë përmes ZKA dhe ZKF të organizatës listat e personelit të tyre shëndetësor dhe mbështetës me kategorizimin e përcaktuar më lartë dhe të njëjtat përcillen në Ministrinë e Shëndetësisë, të cilat pasi konstatohet përputhshmëria me kriteret e këtij vendimi dhe udhëzimeve nga ana e Sekretarit dhe Ministrit të Shëndetësisë me shkresë të veçante dërgohen ne Thesar/MF.
4. Për kategorinë e III, shtesa paguhet edhe për muajin korrik dhe gusht.

5. Për Kujdesin Parësor Shëndetësorë obligohen komunat të ndajnë mjete financiare nga buxheti i tyre, për zbatimin e këtij Vendimi.
6. Shtesat paguhen në mënyrë retroaktive për muajt për të cilët personeli ka qenë i angazhuar dhe do të fillojnë të ekzekutohen me pagën e muajit nëntor dhe dhjetor varësisht nga sjellja e listave të konfirmuara për ekzekutim.
7. Obligohen institucionet përkatëse të Republikës së Kosovës të ndërmarrin veprimet e nevojshme për zbatimin e këtij Vendimi.
8. Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit në Gazetën Zyrtare të Republikës së Kosovës.

Avdullah HODI



Kryeministër i Republikës së Kosovës

Iu dërgohet:

- Zëvendëskryeministrave
- të gjitha ministrive (ministrave)
- Sekretarit të Përgjithshëm të ZKM-ës
- Arkivit të Qeverisë